



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 573 Prot.

Tiranë, më datë 05.03.2020

VENDIM

Nr. 92, datë 05.03.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 05.03.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit dhe dokumentimin për 2 varreve të evidentuara në pjesën jug-perëndimore, në lagjen “Pojan”, rruga Apolloni – Shtyllas, Fier, me kërkesë të ZAKPA Apoloni dhe Bylis;
2. Gërmimi arkeologjik i shpëtimit do të realizohet nga specialistët e ZAKPA Apolloni;
3. Rezultatet e gërmimit të shpëtimit të kalojnë për miratim në KKTKM e radhës;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

